

**KRONIKË**  
**VEPRIMTARI STUDIMORE MBI PËRKTHIMIN: DISA QASJE**  
**HERMENEUTIKE DHE VËZHGIME TË PROCESIT TË TË**  
**PËRKTHYERIT**

Më datën 15 shtator 2023, pranë Bibliotekës së Institutit të Arkeologjisë (ASA) u mbajt veprimtaria studimore mbi përkthimtarinë dhe qasje hermeneutike në procesin e përkthimit. Në këtë veprimtari të organizuar nga Departamenti i Studimeve Letrare (Institutit i Gjuhësisë dhe i Letërsisë) u mbajtën dy ligjërata që kishin pikënisje pikërisht qasjen hermeneutike dhe një sërë problematikash që lidhen si me përballjen e përkthyesit me sfida jo të pakëta në proceset e përkthimit, ashtu dhe me raste më të veçanta që shpjen në reflektime mbi njohjen e duhur të konteksteve të caktuara në këto të fundit.

E ftuar nderi e Departamentit të Studimeve Letrare ishte dr. Zuzana Finger, që mbajti ligjëratën me titull “Roli i hermeneutikës në transformimin e përkthimit letrar”, duke sjellë për të pranishmit një sërë shembujsh mbi aspekte të shndërrimeve të mundshme sintagmatike në procesin e përkthimit letrar. Njohëse e mirë e gjuhës shqipe dhe e prurjeve në letërsinë bashkëkohore shqipe, me një formim kompleks në të cilin spikat njohja e thelluar e disa gjuhëve të huaja, dr. Finger kishte përzgjedhur tekste të veçanta, të cilat u interpretuan prej saj në disa vështrime, duke pasur parasysh konotacionet përkatëse në gjuhën burimore dhe në atë të përkthimit. Tekstet e përzgjedhura nga dr. Finger sillnin në vëmendje rëndësinë e njohjes së strukturave përkatëse në gjuhët nga të cilat përkthejmë, me nënvizimin e veçanësisë që mbartin pikërisht veprat letrare.

Trajtesa interesante e dr. Zuzana Finger u pasua nga ligjërata me titull “Empatia hermeneutike në procesin e përkthimit”, mbajtur nga kolegu Arian Leka, si një trajtesë me objekt çështje të së njëjtës qasje (hermeneutike), me vëmendje të orientuar nga receptimi i traditave të caktuara letrare, përfshirë dhe letërsinë antike, frymëzuese në disa lamiye të lëvrimit letrar dhe artistik. E iniciuar në një vështrim që rrokte në diakroni disa qasje ndaj përkthimit letrar dhe konceptimit të tij si proces (përfshirë dhe reflektime në të përkohshme shqiptare të shekullit të kaluar), kjo trajtesë mbështetej gjithashtu në qëmtime shembujsh nga autorë e vepra të veçanta, gjithnjë në perspektivën përzgjedhëse të përpilimeve letrare, të reflektuara dhe në realizime të frymëzuara prej tyre dhe të natyrës kinematografike.

**Evalda Paci**

